



# RAPORT VJETOR

## 2010

## 1. Të përgjithshme

- 1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD)
- 1.2 Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave.

## 2. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së ASD-së

- 2.1 Kontributi fillestar.
- 2.2 Primi vjetor i sigurimit dhe politikat e tij.
- 2.3 Kompensimi.
- 2.4 Administrimi i Mjeteve Financiare.

## 3. Gjendja e depozitave të siguruar dhe struktura e tyre

- 3.1 Ecuria e depozitave të siguruar
- 3.2 Struktura dhe numri i depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj

## 4. Gjendja financiare e ASD-së

- 4.1 Struktura e bilancit.
- 4.2 Kapitali dhe ecuria e tij.
- 4.3 Fitimi dhe ecuria e tij.
- 4.4 Kontrolli i librave dhe i llogarive të ASD.
- 4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm.
- 4.6 Raporti i Auditit të Jashtëm

## 5. Një vështrim mbi veprimtaritë e tjera të ASD-së gjatë vitit 2010

- 5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë
- 5.2 Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave.
- 5.3 Edukimi dhe informimi i publikut.

## 6. Drejtimet kryesore të planit të zhvillimit për vitin 2011

## SHKURTIME

<b>ASD</b>	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
<b>IADI</b>	International Association of Deposit Insurers
<b>EFDI</b>	European Forum of Deposit Insurers
<b>FDIC</b>	Federal Deposit Insurance Corporation
<b>SHKK</b>	Shoqëritë e Kursim Kreditit
<b>FSVC</b>	Financial Service Volunteer Corpus
<b>FSAP</b>	Financial Sector Assessment Program
<b>BR</b>	Banka Raiffeisen
<b>AB</b>	Alpha Bank – Shqipëri
<b>ISPB</b>	Intesa Sanpaolo Bank Albania
<b>BKG</b>	Banka Kombëtare e Greqisë, dega Tiranë
<b>BBSH</b>	Banka e Bashkuar e Shqipërisë
<b>BPI</b>	Banka e Parë e Investimeve
<b>BKT</b>	Banka Kombëtare Tregtare
<b>BNT</b>	Banka Ndërkombëtare Tregtare
<b>BE</b>	Banka Emporiki, Shqipëri
<b>BPC</b>	Banka ProCredit
<b>VB</b>	Veneto Banka
<b>BT</b>	Banka Tirana
<b>BC</b>	Banka Credins
<b>BKSH</b>	Banka e Kreditit e Shqipërisë
<b>BSG</b>	Banka Societe Generale Albania
<b>UB</b>	Union Bank



## 1. TË PËRGJITHSHME

### **1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD)**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është institucion i krijuar në bazë të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002, "Për Sigurimin e Depozitave", ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.03.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave".

Qëllimi i krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave lidhet ngushtë me përmbushjen e funksionit të saj kryesor sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë, si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, në bazë të kriterëve dhe niveleve të përcaktuara në këtë ligj.

Me përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, Agjencia ka ndikuar në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, në forcimin e besimit të publikut në skemën e sigurimit të depozitave në Shqipëri, si dhe në shmangien e riskut të humbjes së kursimeve të tyre si pasojë e falimentimit të mundshëm të ndonjë banke, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies ekonomike të vendit.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave bën pjesë në institucionet që krijojnë dhe kontribuojnë në sigurinë financiare të sistemit, së bashku me Autoritetin Mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë) dhe Ministrinë e Financave që është në funksionin e burimit të fundit financiar (*huadhënës i burimit të fundit*).

Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, Agjencia organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Banka e Shqipërisë me propozimin si më poshtë:

- Dy anëtarë nga Banka e Shqipërisë;
- Dy anëtarë nga Ministria e Financave;
- Një anëtar nga Bashkimi Profesional i Ekspertëve Kontabël;
- Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson autoritetin ekzekutiv të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

## **1.2 Anëtarësimi në skemën e sigurimit**

Sipas nenit 3 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia. Në këtë kuptim, anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha bankat që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Numri i bankave të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në fund të vitit 2010 ka qenë 16, të cilat janë banka private shqiptare apo të huaja si më poshtë:

1. Banka Raiffeisen
2. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
3. Veneto Banka
4. Banka Kombëtare Tregtare
5. Banka Tirana
6. Banka Kombëtare e Greqisë, dega Tiranë
7. Banka Ndërkombëtare Tregtare
8. Alpha Bank - Shqipëri
9. Intesa Sanpaolo Bank, Albania
10. Banka ProCredit
11. Banka e Parë e Investimeve
12. Banka Emporiki, Shqipëri
13. Banka e Kreditit e Shqipërisë
14. Banka CREDINS
15. Banka Société Générale Albania
16. Union Bank



## 2. DREJTIMET KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË ASD

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, aktiviteti i së cilës rregullohet në Shqipëri nëpërmjet ligjit nr.8873 datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, siguron depozitat e individëve në sistemin bankar, kujdeset për përfshirjen në kohë të depozituesve në skemën e sigurimit të depozitave dhe kompenson depozitat në bankat të cilave ju hiqet (revokohet) liçenca nga Autoriteti Mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë) sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.

Aktiviteti i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përfshin përcaktimin e primit vjetor të sigurimit për bankat e nivelit të dytë, mbledhjen e kontributit fillestar dhe primit vjetor të sigurimit, verifikimin e saktësisë së përlllogaritjes së këtij primi, investimin e mjeteve financiare si dhe funksionin final kryesor për realizimin e detyrimit të pagesës së kompensimit të depozituesve në bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje dhe me direktivën 94/19 të Komunitetit Europian për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron të gjitha depozitat e individëve në lekë dhe monedhë të huaj, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes. Agjencia siguron depozitat e individëve deri në 2,500 mijë lekë, me afat në lekë, depozitat me afat në valutë, depozitat pa afat në lekë, depozitat pa afat në valutë, çertifikatat e depozitave në lekë, çertifikatat e depozitave në valutë etj.

## 2.1 Kontributi fillestar

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjithë institucionet që ushtrojnë veprimtari bankare në vend. Sipas ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave" i ndryshuar, nenit 23 të tij, çdo bankë e siguruar duhet të paguajë në Agjenci një kontribut fillestar të barabartë me 0.5 për qind të kapitalit të nënshkruar të bankës. Gjatë vitit 2010, skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri nuk iu shtua asnjë subjekt i ri. Sipas ligjit të mësipërm, gjatë vitit të kaluar, norma e përlllogaritjes së kontributit fillestar mbeti e njëjtë.

## 2.2 Primi i sigurimit dhe politikat e tij

Sipas nenit 24 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave" i ndryshuar, për çdo bankë të siguruar, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0.5 përqind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune për tre muajt e fundit të vitit të kaluar. Agjencia mund ta ulë këtë prim deri në 0.1 për qind, vetëm në rast se mjetet financiare të saj, do të jenë jo më pak se 5 përqind të mesatares së këtyre depozitave, veprim i cili kryhet me akt nënligjor. Ky raport, në fund të vitit 2010 arriti në nivelin 2.2 për qind, nga 2 që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sipas nenit 24 të ligjit të mësipërm, pagesa e primit edhe këtë vit u krye në katër këste tremujore sipas afateve të përcaktuara në ligj. Njëkohësisht me pagesën e kështit të parë, bankat sjellin pranë Agjencisë deklaratën e primit e cila konfirmon llogaritjen e primit sipas kërkesave të ligjit. Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave të Agjencisë, për vitin 2010 arritën në shumën **1.941.085 mijë** lekë, të cilat krahasuar me një vit më parë kanë shënuar një rritje prej rreth 81,6 për qind, si impakt i drejtpërdrejtë dhe kryesisht prej rritjes së shumës së mbulimit pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 10 106, datë 30.03.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave". Norma vjetore e primit të sigurimit të depozitave për vitin 2010 u aplikua e njëjtë për të gjitha bankat, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj.

## 2.3 Kompensimi i depozitës së siguruar

Agjencia është institucioni përgjegjës për realizimin e funksionit final të saj, kompensimit të depozitave të klientëve në kohë reale dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj. Kompensimi për llogari të depozitave të siguruara fillon menjëherë pasi Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen në bankën e siguruar dhe përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.


Sipas ligjit "Për sigurimin e depozitave", ndryshuar me ligjin nr. 10 106, datë 30.03.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, në masën 100 për qind dhe në çdo rast, jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për çdo depozitues në çdo bankë të siguruar, që operon në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar.

## 2.4 Administrimi i mjeteve financiare

Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002, “Për sigurimin e depozitave”, si dhe në dokumentin e “Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë”, Agjencia e Sigurimit të Depozitave përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standartet e pranura të menaxhimit të riskut. Administrimi i fondeve realizohet nëpërmjet politikës së investimit të mjeteve financiare të Agjencise në letra me vlerë të qeverisë shqiptare dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare të vendeve të tjera, monedha e të cilave është në llogari depozitë në bankën e siguruar, me maturim të mbetur jo më shumë se një vit.


ASD-ja ka ndërtuar një shpërndarje maturiteti të shkallëzuar të portofolit të saj, me qëllim garantimin e plotësisimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare. Kështu, duke mbajtur parasysh konsideratën për maturitetin, shpërndarja e portofolit me 31.12.2010 rezulton :

**Shpërndarja e portofolit të investimit sipas maturitetit**



Duke mbajtur parasysh konsideratën për peshën specifike të nënportofoleve të mjeteve financiare, shpërndarja e portofolit sipas monedhës më 31.12.2010 rezulton :

**Shpërndarja e portofolit të investimit sipas monedhes**







### 3. GJENDJA E DEPOZITAVE TË SIGURUARA DHE STRUKTURA E TYRE

#### 3.1 Ecuria e depozitave të siguruara

Depozitat e klientëve të sistemit bankar shqiptar, në fund të vitit 2010 u rritën me 18.2 për qind krahasuar me fundin e vitit 2009.


Depozitat e individëve, që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, zënë një peshë prej 81 për qind kundrejt totalit të depozitave në tërë sistemin bankar, kurse depozitat e siguruara përfaqësojnë rreth 69 për qind të depozitave të individëve.

Pjesën më të madhe të depozitave të individëve e zënë depozitat në lekë dhe 46 për qind e tyre janë depozita në valutë.

*Referuar ecurisë së depozitave të individëve për periudhën njëvjeçare dhjetor 2009 – dhjetor 2010, vërehet një rritjen e tyre me 18.2 për qind, kurse depozitat e siguruara u rritën me 14.8 për qind.*

Për periudhën njëvjeçare dhjetor 2009 – dhjetor 2010, për depozitat e individëve në valutë vërehet një rritje prej 7 për qind, dhe një rënie prej 5 për qind e depozitave në lekë.

Ecuria e depozitave të individëve, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare jepet në grafikun e mëposhtëm.



### 3.2 Struktura e numrit të depozituesve dhe shumës së depozitave sipas niveleve të përcaktuara në ligj


Në fund të dhjetorit 2010 depozitat e agreguara të individëve pas netimit, të shprehura në përqindje sipas niveleve, jepen në tabelën më poshtë:

Struktura e Depozitave	Total të agreguara pas netimit	
	Nr.i depozituesve (%)	Shuma (në %)
Deri 2 500 000	96	45
mbi 2 500 000	4	55
<b>Total</b>	<b>100</b>	<b>100</b>


Depozitat me shumën deri në 2 500 mijë lekë, zënë rreth 45 për qind të totalit të depozitave të individëve. Kurse numri i depozituesve, të cilët e kanë shumën e depozitave të tyre të agreguara deri në 2 500 mijë lekë, dominon duke zënë 96 për qind të totalit.

Grafikisht ky informacion paraqitet si më poshtë:

**Struktura e shpërndarjes së numrit të depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj (në %)**




**Shuma e depozitave të agreguara & netuara në %**



Krahasimisht, struktura e shpërndarjes së depozitave të siguruara në nivelet e përcaktuara në ligj, sipas numrit dhe shumës, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

**Shpërndarja e depozitave të agreguara pas netimit dhe e numrit të ndepozitorëve, sipas nivelit të mbulimit (në %)**





## 4. GJENDJA FINANCIARE E ASD

Në zbatim të ligjit “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, nr. 8873 datë 29.03.2002, neni 28, Agjencia mban llogari dhe rregjistra me qëllim që në çdo kohë të pasqyrohet në mënyrë të saktë gjendja financiare e saj, në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin” si dhe Manualin Kontabël të saj të miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.250, datë 15.04.2005 “Për miratimin e Manualit Kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”. Zbatimi i këtij manuali, në mbajtjen e kontabilitetit gjatë vitit 2010 dhe në raportimin e pasqyrave financiare, ka ndikuar në një pasqyrim bashkëkohor më real e më transparent të gjendjes financiare të ASD- së.

Veprimtaria financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është përjashtuar nga tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

### 4.1 Struktura e bilancit

Në mënyrë të përmbledhur dinamika e aktiveve dhe pasiveve të Agjencisë për vitin 2010, sipas treguesve të bilancit, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Përshkrimi (në mijë lekë)	31.12.2010	31.12.2009	Ndryshimi
Aktive të qëndrueshme	63.421	66.293	-2.872
Aktive korrente	10.385.428	7.844.784	+2.540.644
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>10.448.849</b>	<b>7.911.077</b>	<b>2.537.772</b>
Kapitali Agjencisë	10.447.678	7.910.033	+2.537.645
Pasive të tjera	1.171	1.044	+127
<b>TOTAL KAPITALI &amp; PASIVE</b>	<b>10.448.849</b>	<b>7.911.077</b>	<b>2.537.772</b>

## 4.2 Kapitali dhe ecuria e tij

**Kapitali i Agjencisë me datë 31.12.2010 është 10.447.678.173,66 lekë.** Ai përbëhet nga:

- **Fondi themeltar** në shumën 400.000.000 lekë  
Bazuar në Ligjin nr.8873, datë 29.03.2002, "Për Sigurimin e depozitave", neni 19, Fondi Themeltar i ASD-së është kontribut i buxhetit të shtetit, derdhur nga Ministria e Financave në muajin shkurt të vitit 2003 .
- **Fondi i akumuluar** në shumën 7.510.032.710,50 lekë  
Përfaqëson fitimin e akumuluar dhe të pashpërndarë të realizuar nga aktiviteti i Agjencisë gjatë viteve 2002- 2009.
- **Fitimi i vitit ushtrimor** në shumën 2.537.645.463,16 lekë  
Përfaqëson fitimin e realizuar gjatë periudhës raportuese 1 janar- 31 dhjetor 2010.


### PASQYRA E LËVIZJES SË KAPITALIT TË ASD

KAPITALI I AGJENCISE	31.12.2010	31.12.2009
• Kapitali (Fondi Themeltar)	400.000.000,00	400.000.000,00
• Fondi i akumuluar	7.510.032.710,50	5.932.595.059,92
• Fitimi i vitit ushtrimor	2.537.645.463,169	1.577.437.652,20
<b>Kapitali gjithsej i Agjencise</b>	<b>10.447.678.173,66</b>	<b>7.910.032.712,12</b>

Duke analizuar mjetet dhe metodat e administrimit të mjeteve financiare, vërehet një ecuri e qëndrueshme në rritje e kapitalit në vite.

Në mënyrë grafike, ecuria e rritjes së kapitalit në vite shprehet si më poshtë:

#### Ecuria kapitale në vite



#### 4.3 Fitimi dhe ecuria e tij

Fitimi i periudhës ushtrimore të ASD-së realizohet prej **Të Ardhurave** të realizuara të periudhës duke i zbritur **Shpenzimet** e kryera të së njëjtës periudhë:

- **TË ARDHURAT**

Të ardhurat për vitin 2010 janë realizuar në masën **2.615.016.538 lekë**. Ato përbëhen nga:

**Të ardhura nga kontributi fillestar i bankave të siguruar**, përfaqësojnë pagesat e kontributeve fillestare nga bankat e siguruar në përputhje me Ligjin nr.8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave". Gjatë këtij viti nuk kemi pasur të ardhura nga ky burim sepse nuk është futur në sistem asnjë bankë e re.


**Të ardhurat nga primi i sigurimit**, përfaqësojnë detyrimin ligjor të bankave të siguruar për pagesën e primit vjetor të sigurimit të depozitave dhe janë të ardhurat më të rëndësishme në portofolin e ASD-së. Për vitin 2010 të ardhurat nga primi janë **1.941.085.734,94 lekë**.

**Të ardhurat nga operacionet monetare**, përfaqësojnë interesat aktive nga investimi i mjeteve financiare të Agjencisë dhe përbëjnë një tregues të rëndësishëm në fuqizimin e mjeteve financiare të Agjencisë. Për vitin 2010 të ardhurat nga investimet janë **629.506.875,30 lekë** (të ardhura të maturuara). Të analizuar në vite, të ardhurat nga operacionet monetare tregojnë për një qëndrueshmëri në rritje të kthimit nga investimi si dhe për një administrim të mirë dhe me efektivitet të fondeve në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit të riskut.

**Të ardhura nga veprimtari të tjera**, përfaqësojnë të ardhurat nga rivlerësimi i portofolit të letrave me vlerë në monedhë të huaj në shumën **44.423.928,03 lekë**.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e fitimit të ASD-së në vite.

### Ecuria e fitimit në vite



### • SHPENZIMET


Në total shpenzimet e ASD-së për vitin 2010 janë realizuar në masën **77.371.075,11 lekë**.

Tabela e mëposhtme tregon ecurinë ndër vite, të peshës specifike që zenë shpenzimet e realizuara të Agjencisë kundrejt të ardhurave të realizuara të së njëjtës periudhë.

Në lekë	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
Të Ardhura	1.185.611.480	1,407,669,955	1,659,311,566	2,614,991,070
Shpenzime	106,474,951	56,900,552	81,873,916	78,024,475
Pesha specifike e Shpenzimeve/Ardhurave	8.98 %	4.04 %	4.93 %	2.98 %

Grafikisht ky raport dhe ecuria e tij ndër vite paraqiten si më poshtë :

### Raporti i të Ardhurave me Shpenzimet



#### 4.4 Kontrolli i librave dhe llogarive të Agjencisë

Aktiviteti i Agjencisë për vitin 2010, llogaritë dhe regjistrat e saj janë audituar nga auditi i brendshëm. Nga raporti i auditimit rezulton se pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi treguesit financiarë të Agjencisë.

#### 4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm

Lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2010, auditi i brendshëm ka patur si objektiv:

- vlerësimin e besueshmërisë për informacionin financiar dhe të drejtimit;
- vlerësimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm

Në përfundim të auditimit, opinioni për pasqyrat financiare të ASD-së është se: Të dhënat e paraqitura në bilancin kontabël, në pasqyrën e të ardhurave, në pasqyrën *cash flow* dhe në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrojnë në mënyrë të vërtetë dhe të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të ASD-së, performancën financiare dhe fluksin e parave në përputhje me politikat kontabël të përshtatura me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250 datë 15.04.2005, "Për Manualin e Kontabilitetit të ASD".

Për sa i përket vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e institucionit, kanë ndërtuar infrastrukturën apo kuadrin rregullator që kanë ndikuar në menaxhimin me efektivitet të lartë të të gjithë praktikave që përbëjnë zhvillimin e aktivitetit të ASD-së.

Drejtoria ka ndërtuar aspekte praktike të monitorimit mbi kryerjen normale të detyrave, duke identifikuar mangësitë e brendshme dhe duke vendosur sistemin e kontrolleve financiarë dhe të kontrolleve të tjera në mënyrë të tillë që ofron garanci të mjaftueshme për:

- operacione efektive dhe eficiente
- kontrole të brendshëm financiare
- pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat.

Gjatë vitit të kaluar, ASD-ja ka siguruar tregues financiarë që e bëjnë shumë optimiste të ardhmen e misionit të saj. Situatë optimiste ka edhe lidhur me realizimin e treguesve të performancës, të cilat kanë ardhur gjithmonë në rritje dhe në përmirësim të ndjeshëm.

Përfundimisht, auditi i brendshëm shpreh opinionin, se pasqyrat financiare japin vërtetësinë e treguesve financiarë të përgatitur për vitin 2010 nga ASD.

#### 4.6 Raporti i Auditit të Jashtëm

Gjatë vitit 2010, ASD kontraktoi shoqërinë "PricewaterhouseCoopers sh.p.k" për kryerjen e shërbimit të auditimit të jashtëm të "Pasqyrave financiare të Agjencisë për periudhën financiare 1 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009"

Sipas opinionit të dhënë në raportin e audituesit të pavarur "Pasqyrat financiare të periudhës paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 Dhjetor 2009, performancën e saj financiare, flukset e parasë, shpërndarjen e fitimit dhe lëvizjen e fondeve për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Manualin Kontabël të Agjencisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 250, datë 15 prill 2005".





## 5. NJË VËSHTRIM MBI VEPRIMTARITË E TJERA TË ASD GJATË VITIT 2010

### 5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikqyrës i veprimtarisë së Agjencisë sipas ligjit nr 8873 date 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” te ndryshuar, midis të tjerave në miratimin e buxhetit dhe akteve nënligjore që prekin palët e treta, që në rastin tonë janë bankat e nivelit të dytë. Edhe gjatë vitit 2010 ka vijuar bashkëpunimi me këtë institucion, në zbatim të projekteve sipas planit të zhvillimit të miratuar.

Menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 10 106, datë 30.03.2009, të ndryshimeve në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, Agjencia u angazhua për reflektimin e këtyre ndryshimeve në kuadrin rregullativ të saj. Kështu, gjatë vitit 2010 ka bashkëpunuar ngushtë me ekspertë ligjorë të BSH për rishikimin e Udhëzimit “Mbi marrëdhëniet e ASD me bankat e siguruarat” dhe Udhëzimit “Mbi pranimin e bankave në skemën e sigurimit të depozitave dhe çertifikimin e tyre”.

## 5.2 Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave

Edhe gjatë vitit 2010, Agjencia ka vijuar bashkëpunimin me institucionet homologe dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe forcimin e dialogut midis autoriteteve dhe anëtarëve të skemës së sigurimit.

Agjencia si një institucion anëtar i organizatës “Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave” (IADI), në të cilën aderojnë 63 institucione të sigurimit të depozitave, përfaqësohet dhe merr pjesë në mënyrë aktive në komitetet e përherëshme të kësaj organizate dhe në grupet e përherëshme të punës. Aktualisht, Drejtori i Përgjithshëm i ASD-së është anëtar i Këshillit Ekzekutiv të kësaj organizate.

ASD, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në këtë organizëm të rëndësishëm të siguruesve të depozitave, ka ndjekur nga afër zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare në këtë fushë. Në gjysmën e dytë të vitit 2009, një grup pune i përbashkët IADI (Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave) dhe BCBS (Komiteti i Baselit për Mbikqyrjen Bankare), hartuan dokumentin e rëndësishëm mbi “Parimet bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave”, i cili u miratua nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar. Ky dokument, i ngjashëm me parimet bazë ndërkombëtare të mbikqyrjes bankare dhe të shoqërive të sigurimit, identifikon kryesisht drejtimit e politikave për siguruesit e depozitave, të cilat janë kryesisht të përshtatshme me mjedisin, rrethanat dhe strukturat e çdo vendi, por nuk përfshijnë kushtet specifike të tij, ose nuk marrin në konsideratë se si objektivat publike dhe mandatet përkatëse mund të ndikojnë në hartimin e veçorive të një sistemi të sigurimit të depozitave në një vend të caktuar. Parimet bazë ndërkohë u pasuruan më tej gjatë vitit 2010 me një metodologji për vlerësimin e sistemit kombëtar të sigurimit të depozitave dhe vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së tij me standartet ndërkombëtare. Kjo metodologji u zhvillua nga BCBS (Komiteti i Baselit për Mbikqyrjen Bankare) dhe IADI (Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave) në bashkëpunim të ngushtë me EFDI (Forumit European të Siguruesve të Depozitave), Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Gjithashtu Agjencia, si anëtare e Forumit European të Siguruesve të Depozitave, me seli në Bruksel, vijon të angazhohet në mënyrë aktive në shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave shumëpalëshe, lidhur me çështje ndërkufitare si dhe iniciativat për rishikimin e legjislacionit europian të skemave të sigurimit të depozitave.

Pjesëmarrja e Agjencisë në organizatat ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, i shërben harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit të saj në përputhje me standartet ndërkombëtare e në veçanti me Direktivën e Komunitetit European “Për skemat e sigurimit të depozitave” dhe ndryshimeve të saj, për t’i paraprirë përshtatjes së kuadrit legjislativ të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, me kërkesat e “acquis communautaire”.

### 5.3 Edukimi dhe informimi i publikut

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, mbështetur në nenin 30 të Ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, si dhe mbështetur dhe në "Politikat e edukimit dhe informimit të publikut", edhe gjatë vitit 2010 ka vijuar t'i kushtojë rëndësi të veçantë edukimit të publikut për çështje të sigurimit të depozitave.

#### ***Nëpërmjet shpërndarjes në sportelet e bankave të fletëpalosjeve edukuese lidhur me skemën e sigurimit të depozitave.***

Fletëpalosjet me informacion edukues mbi skemën e sigurimit të depozitave të hartuara nga Agjencia, i drejtohen qytetarit shqiptar si depozitues në sistemin bankar, si dhe një fletëpalosje e veçantë i drejtohet punonjësit të bankës, si dy grupet më të rëndësishëm të interesit për skemën e sigurimit të depozitave. Teksti i tyre është fokusuar në dhënien e informacionit në formën e këshillave praktike dhe shembujve konkretë, duke u dhënë përgjigje pyetjeve të depozituesëve dhe punonjësve të bankës lidhur me: shumën e mbulimit, depozitat subjekt i skemës, mënyrën e mbajtjes së të dhënave mbi depozitën, si llogaritet kompensimi në një rast falimentimi, si veprohet me depozitat e përbashkëta, etj. Gjithashtu, Agjencia vijon të pajisë bankat me logon e saj, si dhe çertifikatën e anëtarësimit në skemën e sigurimit të depozitave, të cilat janë të detyrueshme të ekspozohen në ambjentet e bankës.

#### ***Nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve në pikat kryesore kufitare të vendit.***

Agjencia, në bashkëpunim me strukturat kompetente shtetërore, mundëson shpërndarjen e fletëpalosjeve informuese për skemën e sigurimit të depozitave pranë pikave kryesore të kalimit të kufirit (porte, pika kalimi tokësore, aeroport). Shpërndarja e fletëpalosjeve në këto pika shërben për të bërë të njohur tek depozituesit skemën e sigurimit të depozitave, në veçanti për rritjen e ndjeshmërisë tek emigrantët shqiptarë që kthehen në Shqipëri.



## 6. DREJTIMET KRYESORE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT PËR VITIN 2011

Agjencia, në funksion të realizimit të objektivit kryesor të saj, mbrojtjes së depozituesve të vegjël, gjatë vitit 2011 do të fokusojë planin e saj të zhvillimit në drejtimet e mëposhtme:

- 1.1 Rishikimi i kuadrit nënligjor dhe mjeteve praktike të Agjencisë për të mundësuar procesin e vlerësimit dhe forcimit të sistemit të sigurimit të depozitave.
- 1.2 Bashkëpunimi me institucione të specializuara për asistencë teknike me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës për kryerjen e procesit të kompensimit.
- 1.3 Edukimi dhe informimi i grupeve të interesit për çështje të sigurimit të depozitave.

1.1.1 ASD, në zbatim të politikave të edukimit të publikut, si dhe në mbështetje të ambicjeve profesionale të vendit për përafrimin me përvojën më të përparuar ndërkombëtare dhe përhapjen e saj edhe në drejtim të sistemit të sigurimit të depozitave, gjatë vitit 2011, në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, do të zhvillojë një seminar ndërkombëtar me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës, anëtarë të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, specialistë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, si dhe përfaqësues të autoriteteve mbikqyrëse vendorë e të insitucioneve të sigurisë financiare. Në fokus të këtij aktiviteti ndërkombëtar do të jenë:

- i. prezantimi dhe njohja me dokumentin mbi “Parimet bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave”.
- ii. njohja dhe përgatitja profesionale e anëtarëve të IADI-it, me dokumentin mbi metodologjinë e përputhshmërisë së parimeve bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.
- iii. njohja dhe përgatitja profesionale e autoriteteve mbikqyrëse vendore – përgjegjës të sigurisë dhe stabilitetit financiar në vend, me metodologjinë e vlerësimit të parimeve bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.
- iv. vlerësimi i përputhshmërisë së sistemit shqiptar të sigurimit të depozitave me këto parime, identifikimi i nevojave dhe hapësirave për përmirësim të mëtejshëm të tij, si dhe zhvillimi e implementimi i një plani strategjik masash korrektuese.

## BILANCI PËRMBLEDHËS

Për periudhën 01.01.2010 deri 31.12.2010

Në lekë

	AKTIVET	N 31.12.2010	N-1 31.12.2009
<b>A</b>	<b>Mjete Monetare dhe ekuivalentet e tyre</b>	<b>259.587.089,10</b>	<b>2.362.891,14</b>
	1- Mjete monetare prane Bankes se Shqiperise	250.152.280,04	1.076.758,45
	2-Ekuivalente te mjeteve monetare	7.600.000,00	0,00
	3- Llogari administrative prane bankave	1.834.809,06	1.286.132,69
	4- Arka	0,00	0,00
<b>B</b>	<b>Investime ne Letra me Vlere te Qeverise</b>	<b>9.627.856.162,49</b>	<b>7.554.773.406,60</b>
	1- Investime ne LVL te Qeverise Shqiptare	8.680.838.316,00	6.642.858.958,00
	2- Investime ne LVL te Qeverive te Huaja	1.210.380.230,00	1.152.690.590,00
	3- Interes i Arketueshem (Bono Thesari)	-272.889.631,00	-252.348.785,00
	4- Skonto, cmimi, primi LVL	9.527.247,49	11.572.643,60
<b>C</b>	<b>Llogari te Arketueshme</b>	<b>497.984.646,09</b>	<b>287.647.760,52</b>
	1- Prime te arketueshme	485.271.430,96	267.102.114,39
	2- Interes i perlogaritur si e ardhur (LVL)	12.683.479,13	20.515.910,13
	3- Kerkesa per arketim ndaj Bankave te falimentuara	0,00	0,00
	4- (-) Zhvleresimi i kerkesave per arketim	0,00	0,00
	5- Te tjera te arketueshme (debitore)	29.736,00	29.736,00
<b>D</b>	<b>Aktive te tjera</b>	<b>63.421.107,98</b>	<b>66.293.070,26</b>
	1-Aktive te Qendrueshme	61.807.105,90	64.574.067,70
	a- Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara	1.083.600,00	1.083.600,00
	b- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	92.844.464,50	92.444.605,50
	(-) Zhvleresim i Akumuluar i AQ	-32.120.958,60	-28.954.137,80
	2- Materiale	1.381.408,08	1.479.119,56
	3- Shpenzime per tu shperndare	232.594,00	239.883,00
	<b>TOTALI (A+B+C+D)</b>	<b>10.448.849.005,66</b>	<b>7.911.077.128,52</b>
	Llogari Jashte Bilancit		
	Kerkesa per arketim		
	Te tjera llogari angazhimesh		
	<b>AKTIVET GJITHSEJT</b>	<b>10.448.849.005,66</b>	<b>7.911.077.128,52</b>

Në lekë

	DETYRIMET DHE KAPITALI (PASIVET)	N 31.12.2010	N-1 31.12.2009
<b>A</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>1.170.832,00</b>	<b>1.044.416,40</b>
	<b>I. Detyrime Afatshkurtra</b>	<b>1.170.832,00</b>	<b>1.044.416,40</b>
	1. Kompensimi I depozitave te siguruara	0,00	0,00
	2. Kred/ Hua Afatshkurtra	0,00	0,00
	3. Kreditore te tjere	<b>1.170.832,00</b>	1.044.416,40
	* Shpenzime Utilitare, (te llogaritura)	453.582,00	208.436,40
	* Kreditor per kontrata	93.736,00	249.916,00
	* Detyrime per Sigurime shoqerore/shendetesore	271.601,00	260.096,00
	* Detyrime per Tatim mbi te ardhurat	351.913,00	325.968,00
	<b>II. Detyrime Afatgjata</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
	1. Kredi/Hua Afatgjata		
	2. Kreditore te tjere		
	<b>III. Provigjone</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
	1. Provigjone te pergjitheshme		
	2. Provigjone per humbje nga falimentimi		
	3. Provigjone te tjera		
<b>B</b>	<b>TE ARDHURA TE MARA NE AVANCE</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>C</b>	<b>SUBVENCIONE DHE DONACIONE</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>D</b>	<b>FONDE</b>	<b>10.447.678.173,66</b>	<b>7.910.032.712,12</b>
	I. Fondi themeltar (kapitali I themelimit)	400.000.000,00	400.000.000,00
	II. Rezervat	0,00	
	III. Fondi I Akumuluar	7.510.032.710,50	5.932.595.059,92
	IV. Fitimi dhe Humbja (-) e vitit Ushtrimor	2.537.645.463,16	1.577.437.652,20
	<b>TOTALI (A+B+C+D)</b>	<b>10.448.849.005,66</b>	<b>7.911.077.128,52</b>
	Llogari Jashte Bilancit		
	Te ardhura ne pritje per arketim		
	Te tjera llogari angazhimesh		
	<b>PASIVET GJITHSEJT</b>	<b>10.448.849.005,66</b>	<b>7.911.077.128,52</b>

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

NR	PASQYRA E TE ARDHURAVE (ne leke)	N	N-1
		31.12.2010	31.12.2009
	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>2.615.016.538,27</b>	<b>1.659.311.566,14</b>
	<b>Nga keto:</b>		
<b>A</b>	<b>Nga veprimtaria e sigurimeve</b>	<b>1.941.085.734,94</b>	<b>1.068.408.485,28</b>
	1. Te ardhura nga Kontributi fillestar	0,00	0,00
	2. Te ardhura nga primet	1.941.085.734,94	1.068.408.485,28
	3. Te ardhura te tjera qe lidhen me to		
<b>B</b>	<b>Nga veprimtaria operative</b>	<b>629.506.875,30</b>	<b>481.166.552,56</b>
	1. Te ardhura nga interesi i depozitave	13.031.863,22	5.200.371,33
	2. Te ardhura nga interesi i Letrave me Vlere	616.475.012,08	475.966.181,23
	a- te Qeverise Shqiptare	587.359.752,00	425.205.923,00
	b. te Qeverive te Huaja	29.100.362,67	50.046.771,53
	c. te ardhura te tjera qe lidhen me to (skonto + int bankare)	14.897,41	713.486,70
	3. Diferenca konvertimi	0,00	0,00
<b>C</b>	<b>Rimarje provigjonesh</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>D</b>	<b>Te ardhura nga falimentimi</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>E</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>44.423.928,03</b>	<b>109.736.528,30</b>
	1. te ardhura nga rivlersimi i letrave me vlere	44.423.928,03	109.736.528,30
<b>1</b>	<b>TOTALI A+ B+ C+ D+ E</b>	<b>2.615.016.538,27</b>	<b>1.659.311.566,14</b>
NR	PASQYRA E SHPENZIMEVE (ne leke)	N	N-1
		31.12.2010	31.12.2009
<b>A</b>	<b>Shpenzime Operative</b>	<b>45.790.611,09</b>	<b>49.615.066,84</b>
	1. Shpenzime materiale dhe te ngjashme	16.748.682,81	12.697.048,09
	2. Shpenzime financiare	3.166.820,80	34.050.419,55
	3. Amortizimi i Aktiveve te Qendrueshme	25.875.107,48	2.867.599,20
	4. Kuota e shpenzimeve per t'u shperndare	0,00	0,00
<b>B</b>	<b>Shpenzime Personeli</b>	<b>27.736.894,02</b>	<b>26.629.127,76</b>
	1. Paga + shperblime	24.840.809,02	23.080.192,92
	2. Sigurime shoqerore	1.867.911,00	2.034.769,00
	3. Te tjera te ngjashme	1.028.174,00	1.514.165,84
<b>C</b>	<b>Tatime Taksa e te ngjashme</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>D</b>	<b>Provigjone</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>E</b>	<b>Te tjera operative</b>	<b>3.843.570,00</b>	<b>3.686.041,00</b>
	Shpenzime Bordi	3.843.570,00	3.686.041,00
	Te tjera shpenzime operative	0,00	0,00
<b>F</b>	<b>Shpenzime Falimentimi</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>G</b>	<b>Shpenzime te periudhave te kaluara</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>H</b>	<b>Shpenzime te jashtezakonshme</b>	<b>0,00</b>	<b>1.943.680,00</b>
<b>K</b>	<b>Te tjera</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
	<b>TOTALI A+ B+ D+ E+ F+ G+ H+ K</b>	<b>77.371.075,11</b>	<b>81.873.915,60</b>
<b>E1</b>	<b>Te tjera operative (diferenca konvertimi)</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
	Diferenca rivleresimi te LVL ne EURO	0,00	0,00
	Diferenca rivleresimi te LVL ne USD	0,00	0,00
<b>2</b>	<b>TOTALI A+ B+ D+ E+ F+ G+ H+ K+E1</b>	<b>77.371.075,11</b>	<b>81.873.915,60</b>
	<b>REZULTATI</b>	<b>2.537.645.463,16</b>	<b>1.577.437.650,54</b>



## PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE

(Për datën 31.12.2010)

(ne 000/Leke)

	PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE	31.12.2010 N	31.12.2009 N-1
<b>1</b>	<b>AKTIVITETE OPERATIVE</b>		
	* Fitimi i vitit	<b>2.537.645,00</b>	<b>1.577.438,00</b>
	* Amortizimi	3.167,00	2.868,00
	*Prime te Arketueshme	- 210.337,00	- 15.946,00
	* Rritje ne letra me vlere deri ne maturim	- 2.073.083,00	- 1.768.417,00
	* Rritje te aktiveve te Tjera	105,00	- 679,00
	* Renie e detyrimeve	127,00	- 787,00
		-	-
	<b>Fluksi i parave nga Aktivitetet Operative</b>	<b>257.624,00</b>	<b>- 205.523,00</b>
<b>2</b>	<b>AKTIVITETE INVESTUESE</b>		
	* Blerje e Aktiveve te Qendrushme te trupezuara	- 400,00	- 956,00
	<b>Fluksi i Parave nga Aktivitete Investuese</b>	<b>- 400,00</b>	<b>- 956,00</b>
	<b>Rritja (Pakesimi) neto i parase gjate Vitit (1 +2)</b>	<b>257.224,00</b>	<b>- 206.479,00</b>
	Gjendja e parase ne fillim te vitit	2.363,00	208.843,00
	<b>Gjendja e parase ne fund te vitit</b>	<b>259.587,00</b>	<b>2.363,00</b>